KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEĆA KOSOVA

# FLETINFORMACION PËR ÇËSHTJEN

**Numri i çështjes:**
**KSC-BC-2023-10**

Prokurori i Specializuar kundër:


Sabit Januzi


Ismet Bahtijari


Haxhi Shala

**Faza e çështjes:**
**PROCEDURË PARAPRAKE**

# TË AKUZUARIT/AKUZAT

**SABIT JANUZI**
**Datëlindja:** 29/04/1966
**Funksionet e pretenduara gjatë periudhës së mbuluar prej Aktakuzës:**

- është shtetas i Kosovës, i lindur në Bërvenik, Kosovë.

**ISMET BAHTIJARI**
**Datëlindja:** 27/02/1963
**Funksionet e pretenduara gjatë periudhës së mbuluar prej Aktakuzës:**

- është shtetas i Kosovës, i lindur në Fushticë të Poshtme, Kosovë.

**HAXHI SHALA**
**Datëlindja:** 17/03/1970
**Funksionet e pretenduara gjatë periudhës së mbuluar prej Aktakuzës:**

- është shtetas i Kosovës, i lindur në Banjë, Malishevë, Kosovë.

### Përshkrimi i akuzave

Sipas aktakuzës së konfirmuar, "Dëshmitari 1" është person që ka dhënë informacion, ose ka shumë të ngjarë ta bëjë këtë, për Task Forcën Hetimore Speciale, ZPS-në ose Trupit Gjykues të DHSK-së për krime ose vepra penale që përfshihen në juridiksionin e DHSK-së. Në aktakuzë thuhet se, midis 5 prillit 2023 dhe 12 prillit 2023, Shala, Januzi dhe Bahtijari, në bashkëpunim me individë të tjerë, bashkërenduan si grup para dhe pasi Januzi dhe Bahtijari e kontaktuan Dëshmitarin 1.

Në aktakuzë më tutje thuhet se, me urdhër të Shalës, Januzi dhe Bahtijari e takuan individualisht Dëshmitarin 1 në dy raste të veçanta për ta nxitur që të tërheqë dëshminë ose të mos japë dëshmi në procedurat zyrtare para Dhomave të Specializuara të Kosovës, përfshirë duke përdorur kërcënime të rënda dhe premtim të përfitimeve.

### Format e përgjegjësisë

Kryerje të drejtpërdrejtë/Tentativë për të kryer vepra penale
Bashkëkryerje/Marrëveshje për të kryer vepra penale
Ndihmë në kryerjen e veprave penale

### Akuzat

1. Pengim të personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare, me anë të kërcënimit të rëndë (vepër penale kundër rendit publik)
2. Pengim të personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare, me anë të pjesëmarrjes në veprimin e përbashkët të një grupi (vepër penale kundër rendit publik)
3. Frikësim gjatë procedurës penale (vepër penale kundër administrimit të drejtësisë dhe administratës publike)

# KRONOLOGJIA

Pas arrestimit nga Prokurori i Specializuar, Sabit Januzi dhe Ismet Bahtijari u transferuan në njësinë e paraburgimit të DHSK-së në Hagë më 6 tetor 2023, ndërsa Haxhi Shala u transferua më 12 dhjetor 2023.

Fillimisht ishin dy çështje gjyqësore të veçanta: njëra kundër Januzit dhe Bahtijarit (numri i çështjes KSC-BC-2023-10) dhe tjetra kundër Haxhi Shalës (KSC-BC-2023-11).

Në dhjetor 2023, ZPS-ja kërkoi bashkimin e këtyre dy çështjeve dhe, në shkurt 2024, Gjykatësi i Procedurës Paraprake miratoi kërkesën. Më pas, çështjes gjyqësore të bashkuar iu caktua numri KSC-BC-2023-10.

# **TË CAKTUAR** NË KËTË ÇËSHTJE

### GJYKATËSI I PROCEDURËS PARAPRAKE



Gjykatësja Marzhori Maselo

### ZYRA E PROKURORIT TË SPECIALIZUAR (PËRFAQËSUESIT KRYESORË)



Taznin Shahabudin

### MBROJTJA (MBROJTËSIT KRYESORË)



Xhonatan Ris (për S. Januzi)



Felisiti Xherri (për I. Bahtijari)



Tobi Kadman (për H. Shala)

## Për më shumë informacion përdorni kamerën e telefonit tuaj për të skanuar kodet e mëposhtme:

Faqja e çështjeve gjyqësore

Kalendari i gjykatës

Faqja e aktualiteteve

Kanali Youtube i DHSK-së

Profili X i DHSK-së

Profili Instagram i DHSK-së


KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEĆA KOSOVA